

BULETIN MUJOR



Shqipëria ndër vendet në krye të OECD mbi rezultatet e Anketës Ndërkombëtare për Mësuesit

Për herë të parë, Shqipëria u bë pjesë e TALIS, mes 55 sistemeve arsimore të OECD, me pjesëmarrjen e ku në disa prej parametrave ka arritur tregues shumë pozitive, shpesh edhe mbi mesataren e vendeve të OECD. Ministria e Arsimit Mirela Kumbaro prezantoi rezultatet e kësaj ankete në një takim me pjesëmarrjen e kryeministrit Edi Rama, mësuesve dhe drejtuesve të shkollave. Sipas rezultateve të kësaj ankete, Shqipëria renditet e para në Europë për treguesin e mirëqenies emocionale dhe sociale: 80% e mësuesve shqiptarë.



Certifikohen 112 oficerë të rinj të sigurisë në shkolla

112 Oficerë të rinj të dedikuar për sigurinë në shkollat e vendit, janë certifikuar në Akademinë e Sigurisë për t'iu bashkuar kolegëve të tyre në shkollat e gjithë vendit, me qëllim kryesor garantimin e një mjedisi të sigurt mes nxënësve brenda në shkollë si dhe një mjedisi të sigurt për ta në territorin e shkollës. Që prej vitit 2019, Akademia e Sigurisë zhvillon trajnimin për oficerë sigurie në shkolla sipas një kurrikule të miratuar dhe ky është brezi i shtatë i oficerëve që punësohen pranë shkollave të vendit.



Nis viti i ri akademik 2025-2026

Më 6 Tetor nisi viti i ri akademik 2025-2026 në gjithë universitetet e vendit. 19.671 studentë ishte shifra e të regjistruave deri në datën 5 Tetor, ndërkohë që regjistrimet janë të ndara në tre raunde. Ministria e Arsimit Mirela Kumbaro uroi nga universiteti "Luigj Gurakuqi" në Shkodër nisjen e vitit të ri akademik, nga ku theksoi se politikat e arsimit të lartë kanë fokus onën europiane të arsimit dhe kërkimit shkencor, si edhe dyfishimin e investimeve në infrastrukturë dhe mbështetjen e programeve të doktoraturës.



READ - Konferenca Ndërkombëtare Shkencore që bashkoi studiuesit e vendit me diasporën akademike

Konferenca Shkencore READ bashkoi në Tiranë diasporën akademike me studiuesit e vendit. U mbajt në Tiranë Konferenca Ndërkombëtare Shkencore READ, në vijim të punës së këtij programi që bashkon kërkimin shkencor të universiteteve shqiptare me përvojën e diasporës akademike me synim rritjen e cilësisë të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit të universiteteve. Ministria e Arsimit Mirela Kumbaro përshëndeti këtë konferencë dhe konfirmoi lajmin e vazhdimin të bashkëpunimit mes Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) dhe Agjencisë Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacion për "READ" në periudhën 2026-2030.



U mbajt në Mal të Zi Ministeriali i vendeve të Ballkanit Perëndimor për Kërkim Shkencor dhe Inovacion

U mbajt në Podgoricë Ministeriali i vendeve të Ballkanit Perëndimor për Kërkim Shkencor dhe Inovacion me fokus infrastrukturën kërkimore dhe Inteligjencën Artificiale. Ministria Kumbaro prezantoi para ministrave dhe eurokomisioneres për Startup, Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin Ekaterina Zaharieva, zhvillimet më të fundit të Shqipërisë duke vendosur fokusin tek rritja e fondeve për kërkim shkencor dhe dyfishimi i investimeve në infrastrukturën kërkimore.



Ministria e Arsimit nis përgatitjet për Maturën Shtetërore 2026

Komiteti i Organizimit të Maturës Shtetërore KOMSH ka nisur zyrtarisht punën përgatitore për Maturën Shtetërore 2026, një proces me rëndësi të veçantë për mijëra nxënës që përmbyllin arsimin e mesëm në të gjithë vendin. Në një takim të zhvilluar me Ministren e Arsimit, Mirela Kumbaro dhe përfaqësues të institucioneve përgjegjëse, u përcaktuan pikat kryesore të planit të punës me qëllim garantimin e një procesi të drejtë, të qetë dhe transparent për çdo maturant. Ky proces do të vijojë në javët në vijim me takime teknike, përditësim të udhëzimeve dhe harmonizim të procedurave në të gjitha qarqet e vendit.